

FJALA E DEPUTETIT ALBAN XHELILI E HËNË 23 TETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Ju uroj punë të mbarë në këtë 4-vjeçar të legjislaturës XI! Mirënjohje për të gjithë qytetarët e Durrësit dhe zonës që unë përfaqësoj, zonës së Plazhit, Shkozetit, Arapajt, Shkallnurit, Xhafzotajt, Rrashbullit, Manskurisë, Romanatit! Për mua poltroni i deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë është po aq privilegj sa edhe përgjegjësi morale, shoqërore e politike, për angazhime e detyra që kanë të bëjnë me mbrohtësinë e vendit të qytetarëve, edhe atyre përtej votuesve të mi dhe të Partisë Socialiste. Pra, personalisht, për mua si deputet rishtar është një emocion i veçantë, ndoshta ndihet edhe nga zëri im dhe pres ta përjetoj me dinjitet, duke plotësuar detyrat që burojnë nga kjo pozitë, si ligjvënës. Është hera e parë në këtë foltore dhe dëshiroj që kjo të mos më pengojë të them hapur mendimin tim, idetë e mia për arritjen dhe plotësimin e interesave të qytetarëve shqiptarë, sipas atyre objektivave që mbart program i Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe vendimet e këtij Kuvendi, pa nguruar apo pa mënjanuar qëndrimin kritik ndaj dukurive e shqetësimeve që do të kem nga elektorati i zonës që përfaqësoj. Duke qenë se në këtë legjislaturë, si në kahun tonë, ashtu edhe atë të opozitës ka mjaft prurje të reja dhe cilësore, do të kërkoja dhe do të jap kontributin tim modest që të sjell një frymë të re, pa baltosje inatçore, siç ndodh rëndom dhe, mundësisht, po përdor një shprehje ndoshta të rëndë, të shfarosim konceptin e mosrënies dakord me çdo mendim apo opinion të kundërshtarëve tanë politikë, pa shmangur debatet konstruktive në interes të Shqipërisë dhe shqiptarëve, gjë të cilën e them me kënaqësi se e ndjej me kënaqësi edhe në komisionin ku unë bëj pjesë, në Komisionin e Ekonomisë. Në daljen time të parë në këtë foltore nuk do doja të mbaja një fjalim politik, por dëshiroj të sjell zërin e banorëve të zonës që përfaqësoj në këtë Kuvend. Kam fatin të kem lindur, të jem banues aktualisht dhe të jem rritur në zonën që përfaqësoj, dhe do të përdor një term që përdoret në atë zonë: unë jam çun plazhi. Zona që unë përfaqësoj është një nga zonat me shtrirjen më të madhe territoriale, si dhe me një numër shumë të madh banorësh. Duke qenë e tillë, patjetër që ka edhe problematikat e saj. Pa filluar ende sezoni turistik, shpresat u dukën të vakura dhe ishte një pesimizëm e frymë që ndihej kudo, në të gjitha bizneset që si veprimtari të tyre kanë turizmin. Por, pavarësisht nga një dukuri e tillë, qoftë pushteti qendror, por edhe ai vendor vazhduan normalitetin e tyre, duke marrë masa për pastrimin e tërë vijës së plazhit dhe ripërcaktuan kërkesat e tyre ndaj bizneseve, deri në kujdesin e masave ndaj COVID-19. Ankthi i bizneseve kaloi sapo nisi sezoni me dyndjen e turistëve, sidomos të huaj. Kjo është ajo pjesë që unë kam përjetuar dhe e kanë përjetuar të gjithë banorët e zonës, për të cilën po flas. Si tregues të këtyre që thashë më sipër, po sjell në vëmendjen tuaj disa arritje domethënëse: vitin 2019 mbahej si viti më i miri i turizmit, po ta krahasojmë me vitin 2021, në vitin 2021 pati një rritje prej 5% si të numrit të turistëve, po ashtu edhe të të ardhurave. Gjithashtu, një problem i madh ka qenë edhe sjellja me dëmet e tërmetit. Këtu u tha: “Jo nuk janë dhënë bonuset e qirave, por po ju them se vetëm në vitin 2021 trajtohen 3850 familje me bonus qiraje, nga 5270 që kanë qenë. Problematikat që ka ajo zonë, janë: për zonën e plazhit janë një pjesë e kanalizimeve, sepse pjesa më e madhe është e rehabilituar. Po ju them se ka dy vjet që nuk ka më derdhje të kanaleve të ujërave të zeza në detin

Adriatik, siç ka qenë më përpara. Pjesa e lagjes brenda mbetet problematike. Zona e Arapajt ka një problematikë me azhurnimin e hartave, të cilat bëhen pengesë edhe për investimet në infrastrukturë. Një problem shumë i madh, që mund t'ju duket ju bukur, se unë e kam kujtesën e shkurtër e nuk e di kush e ka bërë, është rruga nga Shkozeti deri në Kavajë, e cila është rruga më skandaloze në Shqipëri. Të bësh një rrugë ku të përcaktosh se një bllok banorësh, ku ka edhe hotele, të mos kenë dalje në plazh, ndërkohë që e kanë 50 metra larg plazhin, vetëm në atë rrugë ndodh. Kështu që do të kërkoja të shikohet edhe ndonjë mundësi aty në atë zonë, sepse do të jetë zgjidhje edhe për trafikun e rënduar në zonën e Golemit. Meqë kam edhe Ministren e Financave këtu, po kaloj pak te pjesa e profesionit ti. Në lidhje me ligjin për regjistrimin e pronarëve përfitues, afati ka qenë data 30 qershor, por dihet që pandemia bëri të pamundur realizimin e këtij afati. Pra, ligji nr. 112/2020 pati ndryshime me aktin normativ nr. 12/25.08.2021. Duhet të shikohet mundësia e shtyrjes së këtij afati deri në fund të vitit, të paktën deri në datën 31. Një gjë tjetër, një pretendim tjetër nga të gjithë profesionistët formalë në Shqipëri, dhe jo ata informalë, kërkohet të zbatohen kërkesat e ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e bizneseve", ku Qendra Kombëtare e Biznesit, e cila është nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Tatimeve dhe të gjitha institucionet, po fus këtu Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Bordin e Mbikëqyrjes e me radhë, duhet të bëjnë të mundur që, kur të dorëzohen pasqyrat financiare, të kontrollohen dhe në fund të jenë të firmosura nga hartuesi, sepse kemi gjetur që e firmos përfaqësuesi ligjor. Përfaqësuesi ligjor mund të mos ketë arsimin e duhur, mund të mos ketë arsim fare, firmos një pasqyrë financiare që...